



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Istogut  
Skupstina Opštine  
Municipal Istog

### Drejtoria Komunale e Arsimit

05.Nr.463/24

Datë: 09.07.2024

Duke vepruar sipas shkresës Nr.ref.3/1868 të MASHTI-it të datës 27.06.2024, e bazuar në Ligjin Nr.04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Ligjit Nr.04/L-138 për Arsimin dhe Aftësimin Profesional e në lidhje me Udhëzimin Administrativ Nr.22/2013 për Numrin maksimal i nxënësve për klasë dhe raporti mësimdhënës nxënës, e në mbështetje të Kormizës së Kurrikulit të Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës, Drejtoria Komunale e Arsimit në Istog , shpall:

### K O N K U R S

Për regjistrim të nxënësve në klasat e 10 (dhjeta),viti shkollor 2024/2025, në Gjimnazin "Haxhi Zeka" në Istog, në IAAP "Mithat Frashëri" Gurrakoc dhe për kandidatët e intresuar në Qendrën Korrektuese në Dubravë , paralelja e IAAP-së "Rudina" Burgu i Dubravës.

Në klasën e dhjetë, në Gjimnazin "Haxhi Zeka" në Istog, sipas planit të regjistrimit për vitin shkollor 2024/2025, mund të regjistrohen 250 nxënës që do të shpërndahen në 10 (dhjetë) paralele.

- Në drejtimin e shkencave natyrore 6 (gjashtë) paralele, 150 nxënës,
- Në drejtimin e shkencave shoqërore 4 (kater) paralele,100 nxënës.

Në IAAP "Mithat Frashëri" në Gurrakoc,sipas planit të regjistrimit për vitin shkollor 2024/2025,do të regjistrohen nxënësit si me poshtë:

Makineri, prodhimtari dhe nderitmtari	Dirigjimi kompjuterik i makinave	1	24
	Operator i prodhimit	1	24
	Metalpunues	1	24
	Automekanik	1	24
	Instalues i ngrohjes, klimatizimit dhe ujësjellësit	1	24
	Teknik i elektronikës	1	24
	Instalues elektrik	1	24
	Ndërtimtari	1	24
Teknologji e informacionit dhe komunikimit	Informatikë	1	24
Shëndeti dhe mirëqenia	Fizioterapi	1	28

Në IAAP -Paralelja "Rudina" në Burgun e Dubravës, planifikohet regjistrimi i kandidatëve nga kjo qendër korrektuese, gjithsejtë 45 kandidatë.

Makineri, prodhimtari dhe nderitmtari	Metalpunues	1	15
	Automekanik	1	15
	Instalues i ngrohjes, klimatizimit dhe ujësjellësit	1	15

- MASHTI do të bëjë monitorimin e procesit të regjistrimit dhe pranimit të nxënësve. Kriteret dhe kushtet për regjistrim për vitin shkollor 2024-2025:

- Shpallja e konkursit më datë **09.07.2024** nga DKA-të;
- Dorëzimi i dokumenteve më **10, 11 dhe 12** korrik 2024
- Shpallja e rezultateve më **13.07.2024**
- Shpallja e konkursit plotësues në muajin gusht për vendet e lira më datë **19. 08. 2024**
- Dorëzimi i dokumenteve për konkurs plotësues më datë **19, 20 dhe 21 gusht 2024**
- Shpallja e rezultateve për konkurs plotësues më **22.8.2024**

Konkursi shpallet edhe në gjuhët e komuniteteve në komunat ku organizohet mësimi për komunitete.

Konkursi shpallet bazuar në Ligjin për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr.04/L-032, Ligjin për Arsimin dhe Aftësimin Profesional Nr. 04/L-138, si dhe në Udhëzimin Administrativ Nr.22/2013, Numri maksimal i nxënësve për klasë dhe raporti mësimdhënës nxënës.

**Sqarim:** Drejtimit për gjimnaze shpallen sipas Kornizës së Kurrikulit të Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës (KKK).

#### **Kushtet dhe kriteret:**

##### **1. Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt**

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të, në gjimnaze dhe IAAP në vitin shkollor 2024-2025, mund të konkurrojnë kandidatët të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç.

Nxënësit të cilët e kanë mbaruar klasën e 9-të jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë njohjen e dëftesave në MASHTI dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

##### **2. Dokumentet e nevojshme për konkurrim**

Nxënësit për të konkurruar për regjistrim në klasën e 10-të në gjimnaze dhe IAAP, duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- Fletëparaqitjen (e cila merret në shkollën në të cilën konkurron)
- Dëftesën origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9) dhe
- Certifikatën e lindjes

##### **3. Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve**

Paraqitja e dokumenteve në gjimnaze dhe IAAP për vitin shkollor 2024-2025, bëhet me datën 10, 11 dhe 12 korrik qershor 2024, në lokalet e shkollës amë, ku nxënësi dëshiron të regjistrohet duke filluar nga ora 8.00-16.00.

Rezultatet për pranimin e nxënësve shpallen në shkollat përkatëse me datën 13.07.2024.

Kthimi i dokumenteve për nxënësit, të cilët nuk janë pranuar do të bëhet prej datës 15.07.2024. Nxënësi i pakënaqur me rezultatin e publikuar, ka të drejtë ankese brenda (2) dy ditë pune, nga koha e shpalljes së rezultateve.

Ankesa parashtrohet në drejtorinë e shkollës. Ankesat në shkallën e dytë behën në Drejtorinë Komunale të Arsimit brenda (2) dy ditë pune, pas pranimit të përgjigjes nga shkolla.

#### A. Kriteret për regjistrim

Nxënësi për regjistrim në klasën e 10-të duhet t'i plotësojë këto kriteret:

- |   |               |
|---|---------------|
| 1. Suksesi nga shkollimi i obliguar                       | (40%) 40 pikë |
| 2. Suksesi nga lëndët prioritare nga shkollimi i obliguar | (20%) 20 pikë |
| 3. Numri i pikëve nga testi                               | (40%) 40 pikë |

Nxënësi maksimalisht mund t'i fitojë (100 %), 100 pikë.

Kriteri i lëndëve prioritare nga suksesi për gjimnaze dhe shkolla të mjekësisë është që mesatarja e këtyre lëndëve të jetë minimum 4.00 (Së pari llogaritet mesatarja e lëndëve veç e veç për klasat (6-9), pastaj mesatarja e mesatareve të atyre lëndëve)

Kriteri i lëndëve prioritare nga testi për gjimnaze dhe shkolla të mesme të mjekësisë është minimumi 40% i pikëve nga ato lëndë.

1. Nxënësi nga suksesi i përgjithshëm i shkollimit të obligueshëm (kl. 6,7,8,9) mund t'i fitojë maksimalisht 40 pikë.

Formula për llogaritjen e pikëve të suksesit është:

$$\text{Suksesi (kl.6 + kl.7 + kl.8 + kl.9)} \times 2 = 40 \text{ pikë max}$$

Nxënësi nga suksesi i përgjithshëm i lëndëve prioritare, maksimalisht mund t'i fitojë 20 pikë.

$$\text{mesatarja e lëndës (I) + mesatarja e lëndës (II) + mesatarja e lëndës (III) + mesatarja e lëndës (IV)} = 20 \text{ pikë max}$$

- **Lëndët me prioritet në sukses sipas drejtimeve të gjimnazeve:**

- a. Gjimnazi i shkencave natyrore: Fizikë, Kimi, Biologji, Matematikë
- b. Gjimnazi i shkencave shoqërore dhe gjuhësore: Gjuhë amtare, Gjuhë angleze, Histori, Gjeografi

- **Lëndët me prioritet në sukses sipas profileve në IAAP**

- a. **Shëndetësi, Bujqësi, Teknologji Ushqimore, dhe Veterinari:**  
Biologji, Kimi, Fizikë, Gjuhë shqipe dhe letërsi

- b. **Makineri, Elektroteknikë, TIK, Tekstil, Gjeodezi, Ndërtimtari, Xehetari, Gjeologji, Grafikë, Komunikacion, Kimi – Teknologji, PTT:**  
Matematikë, TIK, Fizikë, Gjuhë shqipe dhe letërsi
- c. **Ekonomi, administratë:**  
Matematikë, Gjuhë shqipe dhe letërsi, Gjuhë angleze, Gjeografi
- d. **Juridik dhe administratë:**  
Edukatë qytetare, Histori, Gjuhë shqipe dhe letërsi, Gjeografi
- e. **Tregti, Hotelieri dhe Turizëm:**  
Gjuhë shqipe dhe letërsi, Histori, Edukatë qytetare, Gjeografi
- f. **Shkollat Artistike:**  
Gjuhë amtare dhe letërsi, Edukatë qytetare, Art, Muzikë
- Drejtimi pedagogjik – profili bashkëpunëtor muzikor:**  
Nxënësi duhet ta ketë të përfunduar shkollimin e obliguar (kl. IX) dhe testin kombëtar.
- Drejtimi instrumental:**  
Nxënësi duhet ta ketë të përfunduar shkollimin e obliguar (kl. IX) dhe shkollën e ulët të muzikës (kl. I-VII), në klasën e VII të shkollës së muzikës mund të regjistrohen vetëm nxënësit që kanë përfunduar shkollën e ulët të muzikës (kl. I-VI).  
Të gjithë nxënësit që do të regjistrohen në klasën e dhjetë – duhet t'i nënshtrohen provimit pranues nga komisioni i shkollës.

**4. Kriteri i suksesit (notat) në lëndët prioritare për drejtimet përkatëse:**

- **Gjimnazi i shkencave natyrore** - Mesatarja e lëndëve: fizikë, kimi, biologji dhe matematikë së paku duhet të jetë 4 (katër), si dhe 40% të pikëve nga lëndët prioritare në test (20 pikë nga lëndët fizikë, kimi dhe biologji),

$$\frac{mes(Kimi) + mes(Biologji) + mes(Fizikë) + mes(Matematikë)}{4} \geq 4$$

- **Gjimnazi i shkencave shoqërore dhe gjuhësore** - Mesatarja e lëndëve: gjuhë shqipe, gjuhë angleze, histori, gjeografi, së paku duhet të jetë 4 (katër) si dhe 40% të pikëve nga lëndët prioritare në test (40 pikë nga lëndët gjuhë shqipe, gjuhë angleze, histori dhe gjeografi)

$$\frac{mes(Gjuhë\_shqipe) + mes(Gjuhë\_angleze) + mes(Histori) + mes(Gjeografi)}{4} \geq 4$$

- **Shkollat e Shëndetësisë** - Mesatarja e lëndëve: kimi, biologji, fizikë dhe gjuhë amtare së paku duhet të jetë 4 (katër), si dhe 40% të pikëve nga lëndët prioritare në test (20 pikë nga lëndët fizikë, kimi dhe biologji).

$$\frac{mes(Kimi) + mes(Biologji) + mes(Fizikë) + mes(Gjuhë\_shqipe)}{4} \geq 4$$

**B. Përmbajtja e testit – numri i kërkesave (pyetjeve) sipas lëndëve:**

- I. Gjuhë
- |                  |         |                    |
|------------------|---------|--------------------|
| 1. Gjuhë shqipe  | 35 pikë |                    |
| 2. Gjuhë angleze | 15 pikë | (Gjithsej 50 pikë) |
- II. Shkencat shoqërore:
- |              |         |                    |
|--------------|---------|--------------------|
| 1. Gjeografi | 25 pikë |                    |
| 2. Histori   | 25 pikë | (Gjithsej 50 pikë) |
- III. Matematikë
- |                |         |                    |
|----------------|---------|--------------------|
| 1. Matematikë  | 35 pikë |                    |
| 2. Informatikë | 15 pikë | (Gjithsej 50 pikë) |
- IV. Shkencat natyrore:
- |             |         |                    |
|-------------|---------|--------------------|
| 1. Fizikë   | 17 pikë |                    |
| 2. Kimi     | 16 pikë |                    |
| 3. Biologji | 17 pikë | (Gjithsej 50 pikë) |

**5. Renditja e lëndëve me përparësi në test sipas drejtimeve të gjimnazeve:**

**I. Gjimnazi shkencat e natyrës:**

- |  |                         |
|--|-------------------------|
| 1. Shkencat e natyrës - 50             | 50 x 0.4 = 20 pikë      |
| 2. Matematikë dhe Informatikë - 50     | 50 x 0.2 = 10 pikë      |
| 3. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze - 50 | 50 x 0.15 = 7.5 pikë    |
| 4. Shkencat shoqërore - 50             | 50 x 0.05 = 2.5 pikë    |
|  | <b>Totali = 40 pikë</b> |

**II. Gjimnazi shoqëror dhe gjuhësor:**

- |  |                         |
|--|-------------------------|
| 1. Shkenca shoqërore - 50              | 50 x 0.3 = 15 pikë      |
| 2. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze - 50 | 50 x 0.3 = 15 pikë      |
| 3. Matematikë dhe Informatikë - 50     | 50 x 0.15 = 7.5 pikë    |
| 4. Shkenca natyrore - 50               | 50 x 0.05 = 2.5 pikë    |
|  | <b>Totali = 40 pikë</b> |

6. Renditja e lëndëve me përparësi sipas profileve në IAAP

*I. Shëndetësi, Bujqësi dhe Veterinari*

1. Shkencat natyrore - 50  $50 \times 0.4 = 20$  pikë
  2. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze - 50  $50 \times 0.2 = 10$  pikë
  3. Matematikë dhe Informatikë - 50  $50 \times 0.15 = 7.5$  pikë
  4. Shkencat shoqërore - 50  $50 \times 0.05 = 2.5$  pikë
- Totali = 40 pikë**

*II. Makineri, Elektroteknikë, Gjeodezi, Ndërtimtari, Xehetari, Gjeologji, Grafikë dhe Komunikacion, Kimi – Teknologji*

1. Matematikë dhe Informatikë - 50  $50 \times 0.4 = 20$  pikë
  2. Gjuhë amtare dhe Gjuhë angleze - 50  $50 \times 0.2 = 10$  pikë
  3. Shkenca natyrore - 50  $50 \times 0.15 = 7.5$  pikë
  4. Shkenca shoqërore - 50  $50 \times 0.05 = 2.5$  pikë
- Totali = 40 pikë**

*III. Ekonomi*

1. Matematikë dhe Informatikë - 50  $50 \times 0.4 = 20$  pikë
  2. Gjuhë amtare dhe Gjuhë angleze - 50  $50 \times 0.2 = 10$  pikë
  3. Shkenca shoqërore - 50  $50 \times 0.15 = 7.5$  pikë
  4. Shkencat natyrore - 50  $50 \times 0.05 = 2.5$  pikë
- Totali = 40 pikë**

*IV. Juridik*

1. Shkencat shoqërore - 50  $50 \times 0.4 = 20$  pikë
  2. Gjuhë amtare dhe Gjuhë angleze - 50  $50 \times 0.2 = 10$  pikë
  3. Matematikë dhe Informatikë - 50  $50 \times 0.15 = 7.5$  pikë
  4. Shkenca natyrore - 50  $50 \times 0.05 = 2.5$  pikë
- Totali = 40 pikë**

*V. Tregti, Hotelieri dhe Turizëm*

1. Gjuhë amtare dhe Gjuhë angleze - 50  $50 \times 0.4 = 20$  pikë
  2. Shkenca shoqërore - 50  $50 \times 0.2 = 10$  pikë
  3. Matematikë dhe Informatikë - 50  $50 \times 0.15 = 7.5$  pikë
  4. Shkenca natyrore - 50  $50 \times 0.05 = 2.5$  pikë
- Totali = 40 pikë**

*VI. Shkollat Artistike*

1. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze - 50  $50 \times 0.4 = 20$  pikë
  2. Shkenca shoqërore - 50  $50 \times 0.2 = 10$  pikë
  3. Matematikë dhe Informatikë - 50  $50 \times 0.15 = 7.5$  pikë
  4. Shkenca natyrore - 50  $50 \times 0.05 = 2.5$  pikë
- Totali = 40 pikë**

*Pranimin e dokumentacioneve do ta bëjë komisioni i themeluar në kuadër të shkollave përkatëse.*

Drejtori i DKA-së

Naim Behlulaj

*Behlulaj*